

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 490 Prot.

Tiranë, më 11.042017

VENDIM Nr. 54, datë 07.04.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 6, të datës 07.04.2017, pasi shqyrtoi projektin "*Projektimi dhe vendosja e elementeve përbërës të sistemeve të Biletarive Elektronike, për Sitet Historike në Shqipëri* (Kalaja e Shkodrës, Kalaja e Beratit dhe Muzeu i Onufrit, Kalaja e Gjirokastrës, Muzeu Kombëtar Krujë dhe Muzeu Etnografik Krujë, Parku Arkeologjik të Apolonisë) paraqitur nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim,

VENDOSI:

1. Të miratojë projektin "*Projektimi dhe vendosja e elementeve përbërës të sistemeve të Biletarive Elektronike, për Sitet Historike në Shqipëri* (Kalaja e Shkodrës, Kalaja e Beratit dhe Muzeu i Onufrit, Kalaja e Gjirokastrës, Muzeu Kombëtar Krujë dhe Muzeu Etnografik Krujë, Parku Arkeologjik të Apolonisë) paraqitur nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim.
2. Punimet e zbatimit të Biletarive Elektronike, në Sitet Historike të cituara më poshtë, duhet të ndiqen:
 - Për Biletarinë në Kalanë e Shkodrës, nga DRKK Shkodër
 - Për Biletarinë në Kalanë e Beratit dhe në Muzeun e Onufrit, nga DRKK Berat
 - Për Biletarinë në Kalanë e Gjirokastrës, nga DRKK Gjirokastrë
 - Për Biletarinë në Muzeun Kombëtar Krujë dhe Muzeun Etnografik Krujë, nga DRKK Durrës
 - Për Biletarinë në Parkun Arkeologjik të Apolonisë, nga specialisti arkeolog i këtij Parku



3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO
MINISTRE



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO